

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

E nderuar drejtuese e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Në kulmin e krizës së çmimeve, qytetarët shqiptarë janë të vetëm. Sot në këtë sallë duhet të themi disa të vërteta. Qeveria shqiptare është e fundit në rajon për mbështetjen që u ka dhënë qytetarëve shqiptarë përballë rritjes së çmimeve të të gjitha mallrave dhe shërbimeve. E vërteta vjen nga Banka Botërore, sipas së cilës, me një fond sa 0.3% e PBB-së, Shqipëria është e fundit në vendet e rajonit për ndihmën e alokuar për përballimin e çmimeve të rritura si pasojë e situatës në Ukrainë. E ashtuquajtura “paketë e rezistencës” është thjesht një lëmoshë në krahasim me të ardhurat që mbledh buxheti i shtetit.

Pra, qeveria pasurohet, ndërkohë që shqiptarët varfërohen çdo ditë e më shumë. Maqedonia e Veriut është vendi që ka dhënë mbështetjen më të madhe në rajon për qytetarët e vet, 3.6% e PBB-së. Një pjesë e kësaj ndihme, shumë e rëndësishme, 1.5%, ka qenë në formën e përjashtimeve nga taksat, që ka lehtësuar në mënyrë të ndjeshme qytetarët. Lëvizja Socialiste për Integrim ka sjellë një propozim konkret në fillim të krizës për përjashtimin e taksave të qarkullimit dhe të karbonit, pikërisht për të lehtësuar çmimin e karburantit, që ka kapur shifra të frikshme kohët e fundit.

Të ardhurat nga TVSH-ja si pasojë e rritjes së çmimit janë shtuar në arkën e shtetit. Çfarë propozuam ne? Propozuam një nismë, e cila është bllokuar pikërisht nga ky parlament, që nuk guxon dhe ka frikë ta diskutojë edhe në këtë seancë. Nisma ka ardhur pikërisht nga protestat e qytetarëve që mbushën sheshet për rritjen e çmimeve. Të mos vijmë këtu dhe të themi se qeveria ka qenë kaq e ndjeshme derisa krijoi edhe bordin. Jo, të dashur qytetarë. Qeveria nuk e krijoi bordin me iniciativën e saj në momentin kur filloi kriza në Ukrainë, por kur u mbushën sheshet nga qytetarët; qeveria u kujtua të krijonte disa borde për të monitoruar çmimet,

ndërkohë që vendet e përgjegjshme, qeveritë e përgjegjshme në rajon, në momentin që filloi kriza, morën masa për të siguruar qytetarët, për t'i garantuar ata që kjo krizë të përballohej së bashku.

Paketa e rezistencës nuk shërben përveçse për një indeksim pensionesh, që është detyrim ligjor, jo bonus i kësaj qeverie. Mbështetja e pensionistëve me një shtesë prej 3 mijë lekësh, që u artikulua këtu, nuk mund të konsiderohet ndryshe, veçse një tallje në krahasim me çmimet e papërballueshme. Shqiptarët paguajnë taksa, por nuk marrin shërbime nga kjo qeveri. Paratë e shqiptarëve shkojnë në xhepat e atyre që marrin përsipër sot të ndërtojnë rrugë me 20 milionë euro kilometri apo inceneratorë, që nuk kanë funksionuar një ditë të vetme, me kosto rreth 430 milionë euro. Bordi i monitorimit, me të cilin kjo qeveri pretendon se po mbron qytetarët, nëse deri dje ishte një instrument gati-gati pasive, një ditë më parë u konfirmua si bord i vjedhjes.

Një ditë më parë, ky bord e vendosi çmimin e naftës në 258 lekë për litër. Kujt i shërben ky bord? Sepse është e qartë se qytetarëve shqiptarë nuk po u shërben. Të dashur qytetarë, Fondi Monetar Ndërkombëtar në raportin e tij të fundit nxjerr një të vërtetë nga e gjithë puna e bordit të transparencës. Çfarë rekomandon FMN-ja? Rekomandon zëvendësimin e bordit të transparencës me mbështetje të mirëorientuar për të varfrit dhe shtresat më të ekspozuara për mbrojtjen e tyre nga efektet e rritjes së çmimeve. Sot që flasim ne jemi kampionë në rajon për çmimin më të lartë të naftës, ndërkohë që FMN-ja rekomandon zëvendësimin e bordit me politika konkrete që shkojnë në dobi të qytetarëve. Ne e blejmë naftën me një çmim të papërballueshëm.

Çfarë ndodh në Malin e Zi? Çmimi i naftës është 189 lekë litri. Çfarë ndodh në Maqedoni? Çmimi i naftës është 196 lekë litri. Ne jemi kampionë për çmimin e naftës, por jemi të fundit për pagën mesatare dhe të parafundit në rajon për pagën minimale, duke lënë pas edhe Kosovën, e cila, gjithsesi, këtë kohë krize e ka përballuar shumë më mirë sesa qeveria "Rama". Të dhënat e fundit të INSTAT-it flasin për rritje progresive të çmimeve në muajin maj. Rekordet e reja të çmimit të naftës, që certifikon bordi i transparencës, nuk janë aspak ogur i mirë për të ardhmen. Kriza e çmimeve vë edhe më në dukje lakun e varfërisë së qytetarëve shqiptarë dhe shtresave në nevojë.

Të dashur miq,

Kolegë,

Shqiptarë,

30% e popullsisë shqiptare sot jeton me më pak se 5 dollarë në ditë dhe vuajnë çmimet e papërbalueshme. Ka familje që nuk arrijnë të blejnë bukë. Këto mund t'i dëgjoni në kronikat e televizioneve, nëse nuk keni kohë për t'i takuar. Për pensionistët është luks të blejnë fruta, të cilat shiten me çmime marramendëse, sepse pensioni nuk u mjafton për të përballuar ilaçet. Transporti publik, autobusët, nuk ndezin kondicionerët për të kursyer. Këto shërbime ofrohen për pensionistët dhe të varfërit, që ju, si forcë e majtë, duhet t'i përfaqësonit.

Siç rekomandon FMN-ja, shqiptarëve nuk u duhen borde që përcaktojnë çmime tavane në bazë të interesit të njërit apo tjetrit klient të qeverisë, sepse qeveria me këtë vendos përpara interesin e vet dhe të një rrethi të ngushtë klientësh, por aspak interesin e qytetarëve shqiptarë. Më shumë se kurrë, sot na duhen vendimmarrje që t'u vijnë në ndihmë qytetarëve, duke çuar para direkt tek ata, siç ka bërë Kosova, që u ka dhënë 100 euro studentëve, punonjësve të administratës dhe të shtresave në nevojë. Zgjidhja është shumë e thjeshtë: ndërprisni pagesat e inceneratorëve që nuk kanë punuar, pronarët e të cilëve janë në kërkim dhe drejtim të paditur, me dosje që hetohen nga drejtësia.

Kjo është mënyra se si një qeveri e përgjegjshme mund të jetë e dobishme që qytetarët e saj ta përballojnë krizën. Fatkeqësisht, ju prej kohësh nuk përfaqësoni të majtën dhe interesat e shtresës më të varfër të shoqërisë, por klientët dhe ortakët e kësaj qeverie. Ne duhet urgjentisht të rishikojmë të gjitha skemat e subvencioneve, të mbyllim bordet që u shërbejnë kategorive të njerëzve, të cilët krizat i kanë pasur gjithmonë mjet për t'u pasuruar dhe të marrim në shqyrtim kërkesat për heqjen dhe rishikimin e taksave të karbonit apo taksave të tjera. Vetëm në këtë mënyrë do të ndihmojmë ata mbi të cilët rëndon më shumë kjo krizë, të varfrit dhe të pamundurit, që sot përballen me kushtet e mbijetesës. Faleminderit!